



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
QENDRA E ARSIMIT

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje produkte ushqimore për nevojat e kopshteve, çerdheve dhe konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):

03142500-3; 03211300-6; 03221000-6; 15100000-9; 15300000-1; 15411110-6;
15411200-4; 15511000-3; 15540000-5; 15800000-6; 15811100-7; 15850000-1;
15872200-3.

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 15 806 183 (pesëmbëdhjetë milionë e tetëqind e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Përlllogaritja e fondit limit nga grupi i punës i ngritur me urdhërin e brendshëm nr 09 datë 24.04.2026 është bërë bazuar në nevojat e planifikuara për mallrat objekt prokurimi, duke përdorur metodën e testimit të tregut dhe referimin tek çmimet e kontratave të mëparshme me të njëjtën natyrë të realizuara nga vetë autoriteti kontraktor, në zbatim të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 56 dhe neni 76, pika 1/b dhe 1/c.

Vënë në dispozicion nga: Buxheti i Shtetit

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2 pika c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, indryshuar, autoriteti kontraktor, Qendra e Arsimit Lushnje, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe ne mbështetje te Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285/2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar:

Neni 82, i LPP “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentacion që provon:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- **Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”**, në emër të tij, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (*nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Per kete arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesemarrës duhet te jete i licensuar sipas dispozitave perkatese ligjore dhe nen ligjore*).

- **Licencë të kategorisë “II.1.B- Shtitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”**, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (*nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018*).

- **Certifikatë - ISO 9001 2015** për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ose objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim ose ekuivalentin e saj.

- **Certifikatë - ISO 22000 :2018** për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim ose ekuivalentin e saj.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 (ose ekuivalente me të) me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove.

Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 22000 :2018 për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të sigurisë ushqimore. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 22000 :2018 ose (ose ekuivalente me të) me qëllim që të garantohet siguria ushqimore e produkteve objekt prokurimi dhe rrjedhimisht cilësia e tyre.

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Per kete O.E duhet te paraqese **vetëdeklarim** ku te deklaroje se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Shenim: Operatori ekonomik i kualifikuar i pari pas procesit të vlerësimit të ofertave, ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues pranë AK, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. *(Sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 dhe në përputhje me nenin 26, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) **2.2.1** Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros vjetore për të paktën një vit të mos jetë më e vogël se vlera e

përlllogaritur e kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter duhet të përmbushet nga i gjithë bashkimi (secili anëtar), në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" në të cilin gjejmë te përcaktuar se: "Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; , si dhe pikën 1, pikën 2/b, pikën 3 dhe pikën 5 të nenit 43 të VKM nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar ku përcaktohet:

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:
b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Vendosja e ketij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

2.2.2. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të **balanceve** të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024,2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse të Dega e Tatim Taksave dhe të konfirmuara nga ky Autoritet. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter duhet të përmbushet nga i gjithë bashkimi (secili anëtar), në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. (Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e

percaktimeve te nentit 41, te ligjit nr 10091, date 05.03.2009, atehere bilancet duhet te shoqerohen edhe me akt ekspertizen e ekspertit te autorizuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, ”..Gjithashtu Autoritetet ose Entet Kontraktore mund te kerkojne qe Operatoret ekonomik te japin informacione ne Bilancet e tyre vjetore qe te tregojne raportet ndermjet aktivitet dhe pasivitet” të LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij si edhe ligjit nr 10091, date 05.03.2009 .

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin e fundit **2026 (kestet e maturuara)** prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit te QKB, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” kudo që operatori ekonomik ka ushtruar aktivitet sipas QKB. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i bashkimit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP, ”Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur....,si edhe përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Kjo kërkesë është vendosur në mënyrë që AK të ketë një informacion sa më koherent mbi shlyerjen e taksave vendore.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-së dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimit.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë, vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- c) **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të LPP si dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Me anë të këtij kriteri synohet që OE të provojë se ka kapacitetin e duhur teknik dhe profesional për të realizuar kontratën pasi ka realizuar më parë kontrata të ngjashme në sektorin publik apo privat.

-
- a) **2.3.2** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht **3 (tre) punonjës** ndër të cilët **1 shofer dhe 2 punëtorë** për të gjithë periudhën e zbatimit të Marrëveshjes Kuadër (kjo për arsye se operatori ekonomik duhet të marrë përsipër shpërndarjen ditore të ushqimeve në kopshtet, çerdhet, konviktin) Për këtë arsye ofertuesi duhet të paraqesë:
- Kontratë pune dhe listpagesë për muajin e fundit për 2 punëtorët.
 - Kontrate pune, listpagesë për muajin e fundit dhe leje drejtimi mjete të kategorisë B për shoferin. Në rastin kur shoferi është kontraktuar nga OE posaçërisht për këtë shërbim, nuk është nevoja e paraqitjes së listepagesës së muajit të fundit për të.

Argumentimi: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion fuqi punëtore të nevojshme për ekzekutimin e kontratës. Objekti i prokurimit në fjalë është një kontratë furnizimi e cila për disa nga produktet, si buka, fruta-perime dhe artikujt ushqimorë me origjinë shtazore do të kryhet furnizimi ditor duke shpërndarë në të gjithë destinacionet e kërkuara nga AK si kopshtet, çerdhet dhe konvikti i Shkollës së Mesme Profesionale në territorin e Bashkisë Lushnje. Duke marrë parasysh se mjete i transportit të mallrave mund të jetë me qera, AK ka vendosur të kërkojë vetëm kontratën e punës dhe lejen e drejtimit të shoferit, në rastin kur ky i fundit nuk ka qenë punonjës i OE me parë por është kontraktuar posaçërisht për këtë shërbim. Kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës.

Shënim: *Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-së dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimit.*

Kriteri i mësipërm është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit 77 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020” Për prokurimin publik”, dhe neni 40, pika 5/c, të VKM nr.285/2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë, të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin

dhe realizimin me sukses të objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund ti vihen.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë me dokumentacion të rregullt ligjor se ka në pronësi, me qera ose në përdorim për gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të kontratës:

- Të paktën 1 (një) automjet i cili duhet të jete ATV frigorifer per transportin e produkteve si mishi dhe bulmeti dhe të paktën 1 automjet per transportin e produkteve të tjera ushqimore, tw pajisura me dokumetacion te rregullt si më poshtë:
 - Certificate pronesie ose kontrate qeraje te noterizuar me afate te percaktuar te cilat do te jene ne dispozicion deri ne realizimin e kontrates
 - Leje qarkullimi
 - Certificate transporti(te paraqitet automjet i cili pajiset me çetifikate sipas ligjit ne fuqi)
 - Akt kolaudimi
 - Sigurimin e detyrueshem te mjetit
 - Leje e drejtimit te drejtuesve te mjetit si dhe libreze shendetsore.

Shënim: *Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-së dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit përfundimtar dhe fillimit të afateve të ankimimit.*

2.3.4 Ambient të përshtatshëm (magazinë ushqimore dhe ambient frigoriferik) brenda territorit të Bashkisë Lushnje, për ruajtjen e produkteve ushqimore objekt prokurimi.

OE duhet të vërtetojë se ky ambient plotëson kushtet e duhura higjieno-sanitare për ruajtjen e ushqimeve. Për të vërtetuar këtë fakt, OE duhet të paraqesë:

- 1-Akt –miratimi higjieno-sanitar, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Shëndetsor (ISHS).
- 2- Dokumentacion që vërteton se OE e ka këtë ambient në pronësi, të marrë me qera ose në përdorim.
- 3-Deklaratë nga OE që ambjenti i plotëson kriteret e kerkuara.
- 4-Licence QKL me kodin II.1.B (Shtitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore per njerez).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b, pika 5/c dhe 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion fuqinë punëtore të nevojshme si edhe pajisjet e nevojshme teknike për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Duke qenë se AK realizon shpërndarjen e ushqimit sipas nje grafiku shperndarje prane kopshteve dhe çerdheve me drekë, dhe konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale, në territorin e Bashkise Lushnje gjatë gjithë ditës, me orare të ndryshme shpërndarje, është kërkuar një objekt aktiviteti në pronësi ose me qera në qytetin e Lushnjes, pasi ushqimet tërhiqen nga ky objekt fizik dhe pastaj bëhet shpërndarja në të gjithë institucionet që kanë

nevojë, gjatë gjithë ditës së punës dhe në orare të ndryshme. Kjo për të realizuar një shërbim sa më efikas dhe në të mirë të fëmijëve të kopshteve, çerdheve dhe konviktit.

Ky kriter është vendosur edhe në përputhje dhe me Rekomandimin Nr. 10181 Prot, date 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, publikuar në adresën www.app.gov.al si edhe Udhëzimin Nr.22, datë 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorëve të biznesit ushqimor”.

***Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit përfundimtar dhe fillimit të afatëve të ankimit.*

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion të rregullt ligjor që vërteton se:

- Ka në pronësi ose përdorim ose kontratë furnizimi sipas kontratës notoriale me furrë buke (subjekt prodhues/tregtues buke) për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Subjekti i mesiperm të jetë i pajisur me leje higjieno sanitare, license QKL me kodin II.1.A.(1), certifikatën e dezinfektimit 3D, certifikatën e mbrojtjes nga zjarri. Për produktin e mesiperm në rastin kur operatori nuk e ka në pronësi/përdorim duhet që të vërtetojë me kontratë furnizimi me një subjekt prodhues ose tregtues e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit / tregtuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.
- Ka në pronësi, në përdorim ose kontratë furnizimi sipas kontratës notoriale me thertore, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, të pajisur me: Leje higjieno sanitare, Leje mjedisore me kodin III.1.B (therje kafshësh) Licence leshuar nga (QKL) me kodin II.A(1). (thertore). Për thertoren duhet të paraqitet vërtetim nga AKU që thertorja është aktive. Për produktin e mesiperm në rastin kur operatori nuk e ka në pronësi/përdorim duhet që të vërtetojë me kontratë furnizimi të zyrtarizuar e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ose tregtuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: license, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.
- Ka në pronësi, në përdorim ose kontratë furnizimi sipas kontratës notoriale me njësi prodhimi bulmeti, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, të pajisur me: leje higjieno sanitare, leje mjedisore me kodin III.1.B (për trajtimin dhe përpunimin e qumeshtit), Licence leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKB) me kodin II.1.A.(1) dhe II.1.B. Për produktin e mesiperm në rastin kur operatori nuk e ka në pronësi/përdorim duhet që të vërtetojë me kontratë furnizimi të zyrtarizuar e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ose tregtuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

- Dokumentacion te rregullt ligjor qe verteton se ka ne pronesi ose perdorim ose kontrate furnizimi sipas kontratës noteriale me kompleks stallor, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, te pajisur me: Leje mjedisore me kodin III.1.B (per mbarshtim kafshesh), Licence leshuar nga (QKL) me kodin II.3.A dhe II .3 C. Per produktin e mesiperme ne rastin kur operatori nuk e ka ne pronesi/perdorim duhet qe te vertetoje me kontrate furnizimi te zyrtarizuar e cila te tregojte qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ose tregtuesit të mishit ku ky i fundit duhet te permbaje te dhena te plota si: telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi.
- Operatori duhet te kete ne pronesi ose perdorim ose kontrate furnizimi sipas kontratës noteriale me kompleks pularie, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, te pajisur me: Licence leshuar nga (QKL) me kodin II.1.A.1 (prodhim, ambalazhim, etiketim e shperndarje me shumice e vezeve). II.1.B(shitje me shumice te ushqimeve me orgjine shtazore per njerëz). Per produktin e mesiperme ne rastin kur operatori nuk e ka ne pronesi/perdorim duhet qe te vertetoje me kontrate furnizimi te zyrtarizuar e cila te tregojte qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ose tregtuesit te vezeve ku ky i fundit duhet te permbaje te dhena te plota si: telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi.

Kriteret e mësipërme janë vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, te VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Gjithashtu dokumentacionet si licensat e prodhimit apo furnizimit jane kerkuar me qellim vertetimin e aftesise dhe përshtatshmërisë për të kryer veprimtarinë profesionale në fjale e lidhur ngushte me objektin e prokurimit.

Gjithashtu perzgjedhja e ketyre kriterëve eshte bere ne përputhje dhe me **Rekomandimin Nr. 10181 Prot, date 19.11.2018**, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve te veçanta per kualifikim dhe specifikimet teknike per prokurimin e produkteve ushqimore”, te Agjencise se Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombetar te Ushqimit, publikuar ne adresen www.app.gov.al. si edhe Udhëzimin Nr.22, datë 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorëve të biznesit ushqimor”.

2.4 KAPACITETI LIGJOR/PROFESIONAL I OPERATOREVE EKONOMIK

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

1-Licensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit kod:II.1.A.(1)“Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”.

2-Licence te leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit, kodi II.1.B . Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz .

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “ Për prokurimin publik, neni 40 pika 5/a) të VKM-së nr 285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Pika III Hartimi i Kriterëve të Veçanta për Kualifikim,

- **Rekomandimit te përbashket të Agjencise se Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombetar te Ushqimit nr. 10181 prot dhe 8514 prot date 19.11.2018 Ku citohet**

gjithashtu qe...Autoriteti Kontraktor do të mbajë në konsideratë faktin se, nuk lejohet përdorimi i Licencës së një Operatori tjetër ekonomik.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIME TEKNIKE

Nr	Përshkrimi i mallit	Specifikimi Teknik
1.	Bukë Integrale	<ul style="list-style-type: none">• Të jetë bukë e prodhuar me miell integral, cilësi e parë.• Të ketë pamje të rregullt, pa shtypje, pa deformime, pa shenja djegie.• Të ketë ngjyrë karakteristikë e llojit të bukës integrale, kafe e errët.• Konsistenca të jetë elastike me shtypje të lehtë, rikthehet në gjendjen e parë, jo i thërrmueshëm dhe pa shtresa dhe poret të jenë të shpërndara njëllor në të gjithë madhësinë.• Të ketë erë dhe shije të këndshme, pa erë e shije të hidhur, të thartë, myku ose të huaj.• Nuk lejohet kërcitje. <p>Këto tregues përcaktohen me anë të analizës organo-leptike.</p> <ul style="list-style-type: none">• Pesha e bukës të jetë 1 (një) kg.• Masa e caktuar sipas llojit të bukës duhet t'i përgjigjet masës 3-4 orë mbas kohës se pjekjes.• Nuk lejohen lëndë të huaja• Lagështira në % jo më shumë se 49.

		<ul style="list-style-type: none"> • Poroziteti në %, nuk duhet të jetë më pak se 67. • Aciditeti në grade, nuk duhet të jetë më shumë se 7 • Kripa në %, nuk duhet të jetë më shumë se 2. • Buka dërgohet për konsum, nuk duhet të jetë më parë se 3 orë nga koha e pjekjes. • Buka ambalazhohet në qeska letre dhe kuti plastike të lejuara për produktet ushqimore. • Buka duhet të jetë e prerë në feta. • Transporti bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet dhe faktorët e tjerë atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore. • Buka duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.
2	Bukë Thekre	<ul style="list-style-type: none"> • Bukë thekre me miell thekre, cilësi e parë. • Të ketë pamje të rregullt, pa shtypje, pa deformime, pa shenja djegie • Të ketë ngjyrën karakteristike duhet të jetë e bukë së thekrës, kafe e errët. • Konsistenca të jetë elastike me shtypje të lehtë, rikthehet në gjendjen e parë, jo i thërrmueshëm dhe pa shtresa. • Poret të jenë të shpërndara njëllor në të gjithë madhësinë. • Të ketë erë dhe shije të këndshme, e bukës së pjekur mirë. • Pa erë e shije të hidhur, të thartë, myku ose të huaj. • Nuk lejohet kercitje. <p>Këto tregues percaktohen me anë të kontrollit organo-leptik.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pesha e bukës të jetë 1 (një) kg. • Masa e caktuar sipas llojit të bukës duhet t'i përgjigjet masës 3-4 orë mbas kohës së pjekjes. <p>Treguesit fiziko – kimik</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lagështira në % jo më shumë se 49. • Poroziteti në % jo më pak se 67. • Aciditeti në gradë jo më shumë se 7 • Kripa në % jo më shumë se 2. • Buka dërgohet për konsum jo më parë se 3 orë nga koha e pjekjes. • Buka ambalazhohet në qeska letre dhe kuti plastike të lejuara për produktet ushqimore. • Buka duhet të jetë e prerë në feta. • Transporti bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet dhe faktorët e tjerë atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore. • Buka duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.
3.	Bukë e zakonshme gruri	<ul style="list-style-type: none"> • Bukë me miell gruri me rreze 75% • Korja të jetë e lëmuar, pa flluska, pa çarje e pjesë të djegura dhe pa shkëputje të saj nga tulli. Me ngjyrë të njëllorjtë mjalti në të kuqerremtë. • Tulli të jetë masë e njëllorjtë e pjekur mirë, jo e ngjitshme, me pore të shpërndara në mënyrë të njëllorjtë, dhe pa gjurmë mielli të pabrumosur. • Të ketë konsistencë elastike, me shtypje të lehtë rikthehet në gjendjen e parë, jo i thërrmueshëm dhe pa shtresa. – • Era dhe shija: E këndshme e bukës së pjekur mirë. Pa erë e shije

		<p>të hidhur, të thartë myku ose të huaj. Nuk lejohet kërcitje. –</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të ketë formë të rregullt, pa shtypje e deformime. • Proteinat: mbi 12.5 % • Lagështira në tul, % jo më shumë se 45. • Poroziteti në % jo më pak se 70. • Aciditeti në gradë jo më shumë se 4.5 • Kripa në % jo më shumë se 2. Lejohen mënjanimet nga masa e caktuar \pm 3%, për çdo bukë. • Buka ambalazhohet në qeska letre dhe kuti plastike të lejuara për produktet ushqimore. • Buka duhet të jetë e prerë në feta. • Transporti ëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet dhe faktorët e tjerë atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore. • Buka duhet të shoqerohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.
4	Djath i bardhë lope	<ul style="list-style-type: none"> • Kërkohet cilësia e mirë, me prodhim djathi nën/prodakt i qumeshtit të lopës, deles, ose dhisë. • Nuk lejohet prodhim i djathit me përzierje qumësht pluhur ose të kondensuar. • Të jetë i stazhionuar jo më pak se 45 ditë. • Të mos jetë i falsifikuar me niseshte apo lëndë të huaja. • Ngjyrë e bardhë deri në krem. • Forma : prizëm, trekëndësh me një faqe anësore cilindrike. • Masa e formës- të jetë 0.5-1-2-3 kg. • Të ketë erë dhe shije të këndshme, specifike e djathit të butë të stazhionuar, pa shije të hidhur dhe djegëse, pa shije ere të huaj. • Pamja e jashtme dhe e brendshme: e formuar mirë, e pastër dhe pa njolla. • Lejohen plasaritje të lehta në sipërfaqe. • Në prerje të jetë e njëllajtë, e pastër, pa lëndë të huaja, me ngjyrë të bardhë deri në krem. • Lagështira në % , jo më shumë se: Për periudhën 1.05- 30.09, %“52”ϣ. Për periudhën 1.10.- 30.04, %“56”ϣ • Yndyra në lëndët e thata në %, jo më pak se 50. • Kripë në % deri 4 ± 1. • Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara nga Ministria e Shëndetësisë. • Në çdo parti djathi lejohen deri në 5 % copa dhe 2 % thërrime, masa e një cope më e madhe ose = me 50 gr. • Të ruhet në frigorifer deri 12 muaj në temperaturën nga +3 deri ne +5 gradë celsius. • Lagështia e ajrit 95 % • Produkti të shoqërohet me raport analize fiziko-kimike dhe raport analize mikrobiologjike të lëshuar nga institucione (laboratorë) të akredituar për këtë qëllim. • Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm. • Raport analiza fiziko-kimike dhe raport analiza mikrobiologjike duhet të paraqiten në origjinal, ose kopje të njësuara me origjinalin.

5	Gjizë	<ul style="list-style-type: none"> • Gjizë e freskët me ngjyrë të bardhë e prodhuar nga kosi, më pak kripë, pa erëra të huaja dhe jo e thartë, pa myk. • Të ketë strukturë të njëtrajtshme në të gjithë masën, pa thërime djathi. • Lagështia në %, jo më shumë se 68. • Yndyrë, në %, jo më pak se 3. • Gjiza e fresket ambalazhohet në vasketa plastike të valëzuara me masë 0.5 kg. (sipas kerkeses se AK). <p>Mbi çdo ambalazh me gjizë vendoset etiketa në të cilën shënohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimi i prodhuesit. • Emri i produktit. • Pesha neto ose vëllimi i produktit. • Data e prodhimit. • Data e skadencës. • Kushtet e vecanta të ruajtjes. • Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë. • Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në menyrë që të mos shpëputet nga ambalazhi. • Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta ,të dukshme mire,të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit. • Gjiza ruhet ne frigorifer ne temperature 2 - 4 gradë celcius. • Transportimi i gjizës bëhet me mjete frigoriferike. • Produkti të shoqërohet me raport analize fiziko-kimike dhe raport analize mikrobiologjike të lëshuar nga institucione (laboratorë) të akredituar për këtë qëllim. • Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm. • Raport analiza fiziko-kimike dhe raport analiza mikrobiologjike duhet të paraqiten në origjinal, ose kopje të njësuara me origjinalin.
6	Qumësht lëng	<ul style="list-style-type: none"> • Detyrimisht i pasterizuar dhe i sterilizuar. • Gjatë përpunimit dhe tregtimit të zbatohen rregullat higjieno-sanitare e veterinare në fuqi. • Nuk lejohet përdorimi i lëndëve konservuese , neutralizuese dhe të huaja. • Te plotesojë treguesit organo-leptike dhe ato fiziko-kimikë. • Të jetë lëng homogjen ,pa lëndë të huaja që notojnë apo precipitojnë. • Ngjyra e bardhë e njëllajtë,nuancë e lehtë e verdhë . • Shija dhe era të këndshme, lehtësisht e ëmbël, shije e lehtë zierjeje, pa shije ose erë të huaja. • Qumështi duhet të jetë i ambalazhuar me kuti tetrapak në peshë 1 litër. <p>Treguesit fiziko-kimike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dendësia në 20 gradë celcius - jo më pak se 1.028 -1.029 gr/liter. • Pika e ngrirjes jo më e lartë se -0,520 gradë celcius. • Përmbajtja e yndyrës në % jo më e vogël se 1.5 dhe jo më e madhe se 2.

		<ul style="list-style-type: none"> • Aciditeti në grade Tjorner : Në periudhën 01 Tetor - 31 Mars jo më i lartë se 20 Në periudhën 01 Prill - 30 Shtator jo më i lartë se 21 • Përmbajtja e lëndës së thatë pa yndyrë , jo më pak se 8.5%. • Prova e pasterizimit (e fosfatazes dhe peroksidezes) duhet negative. • Pastërtia: pa mbetje me site mendafshi apo merle pambuku dyfishe <p>Ambalazhimi brenda kushteve higjeno-sanitare, me peshe 1 litër ku të jenë vendosur: Marketimi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimi i prodhuesit. • Emri i produktit • Pesha neto ose vëllimi i produktit • Data e prodhimit • Data e skadimit • Përqindja e yndyrës • Temperatura e ruajtjes se produktit • Kushtet e vecanta të ruajtjes • Ngarkesa mikrobike sipas normave te percaktuara nga Ministria e Shëndetësisë. • Ruajtja gjatë transportimit në temperaturë 2 deri në 8 gradë celcius. • Produkti të shoqërohet me raport analize fiziko-kimike dhe raport analize mikrobiologjike të lëshuar nga institucione (laboratorë) të akredituar për këtë qëllim. • Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm. • Raport analiza fiziko-kimike dhe raport analiza mikrobiologjike duhet të paraqiten në origjinal, ose kopje të njësuara me origjinalin.
7	Vezë	<ul style="list-style-type: none"> • Të jenë sipas standartit shtetëror 4N/ECE 42 të vitit 2001 dhe Udhëzimit nr.21 datë 25.11.2010 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. • Të jenë të pastra dhe pa plasje. Lejohen ndotje të lehta. • Të mos ketë erë prishje dhe erë tjetër të huaj. Veza duhet të jetë e klasit A • Të jenë të vendosura në bikerina, ku vezët të kenë një peshë 55 deri 70 gr për /kokërr,të padëmtuara , dhe brenda afatit të skadencës. • Ambalazhi të përmbajë të dhënat si më poshtë: Emërtimi i prodhuesit. Emri i produktit Pesha neto ose vëllimi i produktit Data e prodhimit Data e skadimit Kushtet e ruajtjes
8	Kos	<ul style="list-style-type: none"> • Të jetë prodhim me bazë qumësht lope , i freskët. • Të ketë ngjyrë të bardhë, në sipërfaqe e bardhë në të verdhë. • Të ketë strukturë të ngjeshur, pa pore, në prerje pa shtresa dhe ndarje hirre. • Të ketë shijë dhe erë të këndshme, karakteristike e kosit të

		<p>ëmbël, lehtësisht e thartë.</p> <p>Treguesit fiziko-kimike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aciditi në gradë Tjorner, jo më shumë se 120. • Yndyra në %, 3.5 ± 0.1. • Ngarkesa mikrobike, brenda normave sipas Udhëzimit të Ministrisë së Bujqësisë nr 15 dt.09.09.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”. • Produkti të ketë ambalazh plastik ose qelq hermetik që të garantojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organoleptike të produktit, sipas vendimit Nr.434 datë 11.7.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit” • Ambalazhi të përmbajë të dhënat si më poshtë: Origjina e produktit Emërtimi i prodhuesit Emri i produktit Pesha neto ose vëllimi i produktit Përqindja e yndyrës Data e prodhimit Data e skadimit Kushtet e ruajtjes
9	Mish viçi	<ul style="list-style-type: none"> • Kerkohet mish viçi në rritje (mosha 6-12 muaj) me cilësi që të plotësojë kërkesat e standarteve. • Sipërfaqja e jashtme të jetë e mbuluar me një cipë të hollë tharje. • Sipërfaqja e mishit të ftohur menjëherë pas prerjes të jetë i tejdukshëm. • Tendinat të jenë të ndritshme, elastike dhe të forta. • Mishi të jetë me ngjyrë rozë dhe i dhjamt të jetë me ngjyrë të bardhë. • Të jetë e butë dhe elastike. • Ne prerje të duket kompakt. • Të ketë erë të këndshme, karakteristike të llojit. • Palca e kockave të mbushi të gjithë kanalën e palcës, ngjyra të jetë rozë në të verdhë. <p>Treguesit fiziko-kimike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngarkesa mikrobike, të jetë brenda normave sipas Udhëzimit të Ministrisë së Bujqësisë nr 15 dt.09.09.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”. • Çdo parti mishi shoqërohet me çertifikatën veterinarë me të cilën vërtetohet se nga kontrolli i kryer nuk është prekur nga sëmundje por që është i sigurt dhe lejohet të tregtohet për konsum publik. • Treguesit fiziko-kimikë dhe mikrobiologjikë analizohen në laboratorë të akredituar për këtë qëllim, në ato raste kur dyshohet për ndryshime që ka pësuar mishi. • Mishi ruhet në kushte frigoriferike. • Në gjendje të ftohur ruhet në temperaturë nga 0 deri në $-1\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri në 10 ditë ose në temperaturën 0 deri në $+4\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri në 5 ditë. • Transporti të kryhet me mjete të pastra, frigoriferike, të mbrojtura nga dëmtimet dhe faktorët e tjerë atmosferikë duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e

		<p>produkteve ushqimore të freskëta, si dhe të përshtatshme për ruajtjen e mishit gjatë transportit.</p>
10	Mish derri	<ul style="list-style-type: none"> • Kërkohet mish derri i cilësisë së mirë, përfituar nga therja e përpunimi i shpendëve të gjallë(pulë) sipas procesit teknologjik të përcaktuar duke zbatuar dispozitat veterinare e sanitare në fuqi. • Mishi nuk duhet të përmbajë shtresa dhjami, mbetje të organeve të brendshme, copa gjaku të mpiksur, papastërti të stomakëve, të zorrëve dhe nuk duhet të ketë pjesë të dëmtuara nga goditjet ose abcese të brendshme. • Sipërfaqja e jashtme të jetë e mbuluar me një cipë të hollë tharje. • Sipërfaqja e mishit të ftohur menjëherë pas prerjes të jetë i tejdukshëm. • Tendinat të jenë të ndritshme, elastike dhe të forta. • Në sipërfaqe ka ngjyrë me shtresë dhjami të kuqe, të zbehtë. Në prerje sipërfaqja duket e ndritshme, jo e ngjitshme. Ngjyra e dhjamt e verdhë. • Të jetë i butë dhe elastik. • Të ketë erë të këndshme, karakteristike të llojit. • Palca e kockave të mbushi të gjithë kanalën e palcës, ngjyra të jetë e tejdukshme. <p>Treguesit fiziko-kimike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngarkesa mikrobike, të jetë brenda normave sipas Udhëzimit të Ministrisë së Bujqësisë nr 15 dt.09.09.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”. • Treguesit fiziko-kimikë dhe mikrobiologjikë analizohen në laboratorë të akredituar për këtë qëllim, në ato raste kur dyshohet për ndryshime që ka pësuar mishi. • Produkti të ketë ambalazh që të garantojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit, sipas vendimit Nr.434 datë 11.7.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit” • Mishi të ruhet në kushte frigoriferike. • Transporti të kryhet me mjete të pastra, frigoriferike, të mbrojtura nga dëmtimet dhe faktorët e tjerë atmosferikë duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore të freskëta, si dhe të përshtatshme për ruajtjen e mishit gjatë transportit.
11	Mish pule	<ul style="list-style-type: none"> • Kërkohet mish pule i cilësisë së mirë, përfituar nga therja e përpunimi i shpendëve të gjallë(pulë) sipas procesit teknologjik të përcaktuar duke zbatuar dispozitat veterinare e sanitare në fuqi. • Të ketë pamje të rregullt dhe me ngjyrën natyrale të llojit. • Të jetë i pastër, pa mbetje të zorrëve të trakesë, të kllোকës ose të pendëve. • Në muskujt të mos ketë mbetje të gjakut që shkaktohen nga çgjakësimi jo i rregullt. <p>Treguesit fiziko-kimike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngarkesa mikrobike, të jetë brenda normave sipas Udhëzimit të Ministrisë së Bujqësisë nr 15 dt.09.09.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”. • Çdo parti mishi shoqërohet me çertifikatën veterinare me të

		<p>cilën vërtetohet se nga kontrolli i kryer nuk është prekur nga sëmundje por që është i sigurt dhe lejohet të tregtohet për konsum publik.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Treguesit fiziko-kimikë dhe mikrobiologjikë analizohen në ato raste kur dyshohet për ndryshime që ka pësuar mishi. • Produkti të ketë ambalazh që të garantojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit, sipas vendimit Nr.434 datë 11.7.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit” • Mishi të ruhet në kushte frigoriferike. • Transporti të kryhet me mjete të pastra, frigoriferike, të mbrojtura nga dëmtimet dhe faktorët e tjerë atmosferikë duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore të freskëta, si dhe të përshtatshme për ruajtjen e mishit gjatë transportit.
